

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies
au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO**

T R A N S K R I P T

**NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 13 MARS 2003**

T R A N S K R I P T

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,
ODRŽANE 13. 03. 2003. GODINE**

**MARS – MART
2003**

TRANSKRIPT

**NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS,
TË MBAJTUR MË 13 MARS 2003**

(KJO SEANCË ËSHTË VAZHDIM I SEANCËS SË DATËS
6 MARS 2003 ME REND TË NJËJTË TË DITËS)

Seanca filloi punën në orën 10,00.

**KRYESUES I SEANCËS, AKADEMIK NEXHAT DACI,
KRYETAR I KUVENDIT TË KOSOVËS.**

**BASHKËKRYESUES XHAVIT HALITI, ANËTAR I
KRYESISË SË KUVENDIT TË KOSOVËS.**

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Mirëmëngjes dhe mirë se keni ardhur në seancën e radhës plenare.

Materialin e kemi të gjithë, sepse është ai i njëjti i para një jave.

Pikë e parë e rendit të ditës është – Miratimi i Procesverbalit nga seanca e kaluar.

A ka kush ndonjë vërejtje apo sygjerim? Nuk ka. Ju falemnderit.

Pika vijuese është – Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për likuidimin dhe riorganizimin e personave juridikë në bankrotim.

Ndërrimi i pikave të rendit të ditës është bërë meqë Kryeministri është i zënë në një takim të rëndësishëm të veçantë për Kosovën e që është përcaktuar shumëkohë më parë dhe nuk ka qenë e mundur që t'levizë. Diku rreth orës 11,30 do të jetë i lirë Kryeministri.

Ne, për të mos humbur kohë, po procedojmë me shqyrtimin e Ligjit e pastaj vazhdojmë me fjalën e Kryeministrit.

Shpresova, të nderuar deputetë, se jeni të informuar për këtë dhe është theksuar në materialet tuaja, e nëse jo, kërkoj falje.

Procedojmë me shqyrtimin përfundimtar të dytë të Projektligjit.

Mendoj se deputetët i kanë materialet për këtë Ligj dhe të fillojmë me shqyrtimin e amendamenteve si vijon:

Amendamenti 1.

I propozuar nga deputetja Nerxhivane Dauti, i përkrahur nga komisionet kryesore dhe Komisioni funksional.

Do të thotë një amendament që ka përkrahjen faktikisht të tërë strukturës vepruese në Parlament dhe më mbetet vetëm t'ju pyes:

**Kush është për këtë amendament?
Ju falemnderit.**

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? Askush.

Konstatohet se njëzërit u aprovua amendamenti i parë.

Amendamenti 2.

Deputetja Nerxhivane Dauti, e përkrahur nga komisionet kryesore dhe komisionet funksionale.

**Kush është për këtë amendament?
Ju falemnderit.**

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? Askush.
Ju falemnderit.

Amendamenti 3.

Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa dhe ekonomi, i përkrahur nga komisionet kryesore dhe funksionale.

Para se t'ju pyes – kush është për, ju lutem t'i ç'kyçni celularët që të mos interferojnë..

Kush është për këtë amendament?
Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? Askush.
Ju falemnderit.

Amendamenti 4.

Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa dhe ekonomi, i përkrahur nga komisionet kryesore dhe funksionale.

Kush është për këtë amendament?
Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? Askush.

Amendamenti 5.

Deputetja Nerxhivane Dauti, e përkrahur nga komisionet kryesore dhe komisionet funksionale.

Kush është për këtë amendament?
Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? Askush.
Ju falemnderit.